

URDHËR
Nr. 663, datë 4.12.2023

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE JOPUBLIKE, TË NIVELIT TË ARSIMIT BAZË DHE ARSIMIT
TË MESËM TË LARTË, SHKOLLA “AULONA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 42, pika 7, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”, të subjektit juridik “Shkolla Aulona 1” sh.p.k., me NIPT: K37221202F, licencuar me urdhrin nr. 250, datë 17.9.2003, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Aulona’” dhe urdhrin nr. 320, datë 8.10.2004, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor jopublik parauniversitar, shkollë nëntëvjeçare ‘Aulona’”, me kërkesën e tij.

2. Institucionet arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”, kanë për detyrë:

a) të kthejnë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka;

b) të pajisin çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vendosin në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) të dorëzojnë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”;

b) të marrë masa për transferimin e të gjithë nxënësve të regjistruar në këto institucione arsimore në institucione të tjera të arsimit parauniversitar;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”.

4. Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorja Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucionet arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Subjekti juridik “Shkolla Aulona 1” sh.p.k., me NIPT: K37221202F, të marrë masat për shlyerjen e detyrimeve financiare për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë dhe Bashkinë Vlorë, në

lidhje me veprimtarinë e institucioneve arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë.

7. Urdhri nr. 250, datë 17.9.2003, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar ‘Aulona’” dhe urdhri nr. 320, datë 8.10.2004, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor jopublike parauniversitar, shkollë nëntëvjeçare ‘Aulona’”, shfuqizohen.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, institucionet arsimore parauniversitare jopublike, të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, shkolla “Aulona”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Nina Guga